

MIRELA KANINI  
**PËR PAK DASHURI!**  
ROMAN

---

BOTIMET TOENA



Mirela Kanini

**PËR PAK DASHURI!**

roman

BOTIMET TOENA,  
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Eris Rusi *dhe* Natasha Pepivani

Korrektore letrare: Majlinda Bami

Përkujdesja grafike: Mirjana Madhi

Kopertina: Megi Margolis

ISBN: 9789928376817

© Autorja

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

## KAPITULLI I

E dua shumë qytetin ku jetoj. Ia ndiej mungesën që në momentin e parë që largohem prej tij dhe mezi pres të kthehem përsëri. Nuk e di saktësisht çfarë më mungon aq shumë, sepse qytetet kryesisht kanë struktura të ngjashme dhe ndoshta vetëm dinamika e tyre i dallon nga njëri-tjetri. Janë të mbushur me njerëz që nxitojnë të përmbushin detyrimet ditore ose me njerëz të ngeshëm. Me njerëz të rinj ose të vjetër. Me njerëz të lumtur ose të palumtur. Me njerëz pro ose kundra qeverisë në pushtet.

Por qytetin tim e përjetoj së brendshmi, ndryshe nga çdo hapësirë tjetër. Ndoshta është bukuria e tij e pakrahasueshme që më bën ta ndiej kaq shumë, sepse është i vendosur diku mes maleve mjaftueshëm të larta për t'i dhënë një pamje piktoreske tepër

mahnitëse. Qytet me pyje të dendura, përrenj që rrjedhin gjithandej, me kisha të bukura, me arkitekturë adhuruese dhe me rrugë të rregullta e të pastra. Qytet me njerëz të sjellshëm që nuk kalojnë kurrë pa të përshëndetur në rrugë, dyqane apo kudo gjetkë. Nëse del pak jashtë periferisë, nëpër rrugët gjarpërushe midis fushave të mbjella që gjelbërojnë përbri maleve, syri të kap kështjella si nëpër përralla. Jo më kot shumë turistët e quajnë këtë zonë “*a fairy tale town*”<sup>1</sup>. E ka merituar këtë përkufizim për ato çka ofron dhe, çfarë e bën më interesant, është pozicioni i tij i pakrahasueshëm me qytete të tjera. Një qytet në pikën më jugore të Gjermanisë, saktësisht në zonën bavareze (Alpet Gjermane) dhe vetëm disa kilometra larg Salzburgut të Austrisë. Salzburgu është po aq i bukur dhe një vend ku shpesh arratisemi me shoqërinë nëpër *pub*-et e atjeshme. Sikur të mos ishte e përcaktuar nëpër tabela që ai është në një shtet tjetër, nuk do të shihja ndonjë ndryshim të madh midis Salzburgut dhe qytetit tim e për më tepër që flitet e njëjta gjuhë dhe i njëjti dialekt.

Qyteti im quhet Sonthofen, por shpesh më pëlqen të ngjitem më lart, në Tiffenberg, fshatin ngjitur ku më pëlqen të endem e shkujdesur nëpër rrugët e tij të bukura. Ndonjëherë e bëj me shoqet këtë gjë, por më shpesh vij e pashoqëruar. Është pothuajse si një lloj

---

<sup>1</sup> Një qytet përrallor.

terapië për mua të shkoj atje fare vetëm. Zakonisht vishem sportive, me xhinse, ndonjë bluzë pambuku, një kapele a thua se do të më njohë dikush, lidh një bluzë me mëngë të gjata rreth belit dhe çantën në kurriz. Çuditërisht më pëlqen shumë ky ritual i thjeshtë pa shpenzime dhe përgatitje të gjata.

Është diçka spontane e momentit. Rrugët atje janë kryesisht të vetmuara dhe anash tyre ka pyje pa fund me pemë shumë të larta e të dendura. Shpesh e vras mendjen sa vite mund t'u jetë dashur këtyre pemëve për të arritur ato lloj lartësish. Në hyrje të pyjeve të tilla, ku mund të shkosh e të bësh ecje çlodhëse, sigurisht ka tabela paralajmëruese për kafshët e ndryshme që jetojnë aty. Pavarësisht dëshirës për të qenë më afër natyrës e për të thithur oksigjenin e pemëve dhe energjinë ndoshta dhe kuruese, të paktën të gjendjes shpirtërore, prapë nuk guxoja të futesha e vetme atje. Asgjë nuk kishte ndodhur ndonjëherë në fakt dhe kjo ndoshta sepse njerëzit mbanin me vete “*pepper spray*”, një lloj deodoranti me piper djegës për vetëmbrojtje. Mendohej që arinjtë ishin zhdukur nga Gjermania që në shekullin e nëntëmbëdhjetë, ndërkohë që ujqërit ishin shumëfishuar. Por për mua mjaftonin ato tabela paralajmëruese, ku shkruhej: “Kujdes! Këtu ka ujqër”, që të më mbanin larg pyllit. Madje ndieja një lloj drithërimi kur më binte rruga aty afër dhe e quaja këtë gjë një “episod Kësulëkuqeje”. Ndoshta me të drejtë. Ky pyll me pamje misterioze, i qetë dhe i bukur, disi i pafajshëm, kishte atë pjesën

e tij të errët. Ti kujton se është i mbushur me ketra, drerë e drenusha që bëjnë dashuri të shkujdesur rrzëz pemëve deri në momentin që sheh 3-4 ujqër që ndjekin një tjetër, i cili mban me dhëmbë një kaproll të vogël. Këto, për fat të mirë, nuk i kisha parë unë, por një shoqja ime, e cila ua tregonte me entuziazëm të gjithëve. Atje, askush nuk frikësohej nga këto ndodhi, madje këto lloj lajmesh nuk përbënin ndonjë ndjesi të veçantë. Mbi të gjitha, kjo ishte pjesë e jetës në Alpe, me të cilën unë çuditërisht nuk isha mësuar dot. Sapo kaloja përgjatë shtëpive karakteristike bavareze, nuhasja aromat e fshatit: aromën e barit të krasitur, erën e bajgave të-bagëtive, të restoranteve, ku piqeshin derrkucë, dhe bukë e ngrohtë të zezë. Kënaqësi e veçantë ishte kur kthehesha në shtëpi dhe haja *semela* (panine) të butë e të shkrifët me pak gjalpë dhe djathë fshati. Rrugës, në kthim, shihja me ëndje nga dritarja e autobusit retë që lëviznin shtëllunga-shtëllunga duke krijuar figura të çuditshme. Ishte një peizazh që nuk më mërzitej kurrë dhe në çfarëdolloj sezoni të vitit.

Dashurinë për qytetin ku kisha lindur dhe isha rritur ma kishte injektuar nëna ime. Ajo e donte me një dashuri dhe mirënjohje të thellë, ndonëse ky nuk ishte qyteti i saj i lindjes, madje as vendi ku ajo ishte rritur. Nëna ime nuk ishte as me origjinë gjermane, mbi të gjitha. Ajo kishte tridhjetë vjet që jetonte këtu, ndaj e konsideronte këtë qytet si shtëpinë e saj. Kishte mbërritur këtu kur kishte qenë vetëm



20 vjeçe dhe vendi nga i cili ajo pat marrë arratinë, thirrej me emrin “Afrika e bardhë” e Europës. Nëna ime ishte një minierë historish ngjethëse. Kishte një lloj mllefi ndaj vendlindjes së saj, përzier heraherës me nostalgji, por me shumë duf. Më tregonte vazhdimisht për vuajtjet që kishte kaluar në jetë, të cilat kur i dëgjoje, të dukej sikur kishin dalë direkt nga librat e Dikensit, por me ngjarje më bashkëkohore. Nëna ime nuk i kishte njohur kurrë prindërit e saj dhe ishte ky fakt i vetëm që më mbushte me dhembshuri edhe më të madhe për të. Ajo ishte rritur nëpër jetimore deri në moshën 18-vjeçare. Nëse jeta pat qenë e vështirë në këtë “Afrikë” të vogël, që për koincidence i fillonte emri me “A”, duhet të kishte qenë e paimagjinueshme ta përballoje atë pa prindër, pa përkrahje, e vetme fillikat në atë botë të egër. Gjithsesi, dihet që asgjë e mirë apo e keqe nuk zgjat përjetësisht. Kur ajo kish qenë 18 vjeçe, në vendin e saj kishte ndodhur diçka e pabesueshme: regjimi komunist në Shqipëri ishte përmbysur. Ngjarje kjo tronditëse dhe e paimagjinueshme për një vend të izoluar për gjysmëshekulli. Njerëzit, të dëshpëruar për pak liri, ishin dyndur nëpër ambasadat e huaja. Nëna ime Mariana nuk kishte mundur të ikte. Kishte dashur shumë madje dhe e kishte ëndërruar gjithmonë një arratisje që të ishte një akt i çartur guximi në një vend ku diçka e tillë dënohej me vdekje. Nuk kishte pasur kurajën e duhur dhe nuk e kishin lënë frikërat e së panjohurës, që të futej dhe ajo brenda oborrit të

ambasadave të huaja që ishin bërë strehë e atyre që donin t'i shpëtonin komunizmit. Ambasadat e huaja perëndimore, konsideroheshin territore të shteteve të huaja përkatëse, ku regjimi diktatorial nuk kishte forcë të ushtronte ligjet e tij. Shtypi botëror kishte folur pareshtur për këtë ngjarje ato kohë, ndërsa Mariana së bashku me qytetarët e tjerë që rrinin jashtë kangjellave të ambasadave, ndiqte me kërshtëri çdo ditë progresin e të ikurve. Ajo ndihej si ai zogu që ka qëndruar aq gjatë i mbyllur në kafaz, sa që edhe kur ia hapin derën nuk ka më asnjë dëshirë të dalë jashtë. Nuk kishte pasur shtysën e duhur të hidhej me atë turmë guximtarësh përtej mureve të ambasadave të huaja. Të gjithë prisnin me ankth se çfarë fati i priste ata njerëz që ia dolën të futeshin atje. Prisnin ata jashtë në piskun e diellit të korrikut, prisnin dhe ata brenda, të varur pas fatit që mund t'u buzëqeshte një ditë.

Mariana ishte njeri pa njeri dhe ishte rritur me mentalitetin që nuk mund t'i besonte dot askujt. Kur ndihesh e tradhtuar nga vetë jeta, kur nuk ke askënd të njohur në anën tënde përveç fëmijëve të egër dhe fatkeqë ose kujdestareve të pashpirta, ti nuk di as si të besosh dikë. Më vonë, kur këta njerëz të dëshpëruar, të ikurit e ambasadave, u sistemuan nëpër Gjermani, zërat ishin se atje kishin zbuluar paraajsën. Atje kishte pasur ushqime me bollëk dhe gjëra që në këtë "Afrikën e bardhë" as ishin parë e as ishin dëgjuar. Një nga ato mrekulli, për shembull, kishin qenë frutat tropikale

në çdo sezon, mishra e peshq të shumëllojshëm nëpër dyqane disakatëshe të ndriçuara e me dyer që hapeshin automatikisht sapo u afroheshe. Kur dëgjonte se si ata njerëz dikur të rreckosur kishin tashmë veshje me bollëk, banesë, ushqime dhe gjithçka të siguruar nga shteti, madje pa punuar as edhe një orë, u pendua që nuk i kapërceu edhe ajo ato mure ambasadash. Ky ishte për të gabimi më i madh i jetës së saj dhe iu kthye në obsesion dëshira për t'u larguar. Iu duk sikur kishte humbur një shans jetik. Duhej me çdo kusht t'i shpëtonte asaj pasigurie që sjell varfëria. A ka frikë më të madhe se kërcënimi nga uria ose nga i ftohti, nëse nuk ke një kacidhe as për të blerë dru zjarri për t'u ngrohur? Aq e fuqishme ishte kjo dëshirë arratisjeje, sa vendosi të rrezikonte dhe t'i besonte një kontrabandisti që merrej me transportim ilegal të emigrantëve në drejtim të Gjermanisë. Këta njerëz ishin kthyer në njerëzit më të rëndësishëm asaj kohe dhe të gjithëve iu dukej sikur këta kishin në dorë shpëtimin e tyre nga ferri ku jetonin. Jo vetëm aq, por këta tipa ishin të kamurit e parë, të mirushqyerit, të veshur me rroba të shtrenjta dhe të parët që kishin makina luksoze. Metodrat e transportimit në vendet perëndimore ishin të ndryshme dhe hera-herës të tmerrshme. Por edhe tmerrri nuk është më aq i tmerrshëm kur bëhet normë. Mënyra më e lirë ishte të udhëtoje nën kamionin transportues, i lidhur në një tub. Aty rrije ashtu, teksa makina ecte me orë të tëra derisa kaloje me sukses doganën gjermane apo të

ndonjë shteti tjetër. Në ato kohë fluksi i emigrantëve nga Europa Lindore ishte i pakonsiderueshëm për të pasur rregulla strikte ose kontrolle tejet të detajuara. Një tjetër mënyrë ishte nëpërmjet trenave, por jo si pasagjer i zakonshëm apo udhëtar si në filmin e vjetër romantik “Treni i natës për në Mynih”. Pasi hyje në vendet lindore fqinje, të paktat që kishin hapur kufijtë, udhëtimi bëhej duke e vendosur pasagjerin kontrabandë në pjesën e tavanit. Aty të fusnin në kapakun që e mbërthenin pastaj me perçina. Qëndroje ashtu, ndonjëherë njëzet e katër orë ose më shumë, në rrezik asfiksioni nga mungesa e oksigjenit, që pastaj të shijojë lirinë kur mbërrije në destinacion. Kishte dhe nga ata që udhëtonin të mbyllur në pjesën e prapme të mauneve të mëdha të transportit, por asnjë nga këto mënyra nuk i ishte dukur e përshtatshme nënës sime, Marianës. Për më keq, pas rrëzimit të komunizmit dhe vendosjes së demokracisë në Shqipëri, tashmë shqiptarët nuk përfitonin më azil politik nëpër botë. Supozohej që jeta e tyre nuk ishte më në rrezik nga regjimi në fuqi. Liria e fjalës apo ato çka u ishin mohuar me dekada, mund t’i ushtronin tashmë si të donin. Nuk burgoseshe më me mbi njëzet e pesë vjet pse dëgjoje muzikë të huaj. Nuk burgoseshe më për agjitacion-propagandë edhe pse mund ta shaje si të ta donte kokrra e qejfit qeverinë. Njerëzit e bënin këtë gjë ngado, nëpër kafene, ambiente pune, gostira, vdekje, sikur të donin të mbushnin deficitet e të mos folurit kundër regjimit komunist për gjysmëshekulli.

Por varfëria nuk kishte ndryshuar. Asgjë nuk kishte ndryshuar, por nuk mungonin optimistët që ishin të mbushur me shpresën se gjërat do të ndryshonin shumë shpejt dhe Shqipëria do të kthehej në një Zvicër të Ballkanit. Kishte nga ata që e shihnin me pesimizëm dhe nuk donin të prisnin derisa të rregullohej, sepse edhe Roma vetë nuk u ndërtua brenda një nate. Çfarë ikën pa kthim është koha. Shumë kohë kishte kaluar ashtu kot në prapambetje dhe askush nuk donte të priste më përveç optimistëve entuziastë. Ata që e shihnin gotën gjysmë të mbushur kurdoherë.

Një transportues emigrantësh që banonte në të njëjtin pallat ku jetonte Mariana, i kishte treguar asaj për një mënyrë më të sofistikuar, por që kërkonte para, 800 marka gjermane saktësisht. Këtë transportim do ta kryente vetë dhe fakti që ai ishte njeri i besuar e bënte më tunduese dëshirën për të ikur. Mariana tashmë kishte të dhëna të mjaftueshme se jeta në Perëndim ishte më e sigurt se në Shqipëri. Një ditë, fqinji e kishte këshilluar të vishej mirë, sepse do të paraqiteshin në ambasadën çeke për të marrë një vizë turistike. Tashmë vizat për udhëtime turistike për në vendet lindore ishin liruar shumë. A thua se mirëqenia ishte e tillë sa shqiptarët mund të udhëtonin për eksplorime. Bujari, djali në fjalë, do të merrte Marianën, një vajzë dhe një djalë tjetër, gjithashtu, e fillimisht do të udhëtonin me makinën e tij, me pretendimin si turistë në Çeki, por më pas ai do t'i linte diku buzë kufirit gjermano-çek. Prej andej, ata do të ndiqnin instruksionet që do t'u

jepte ai. Nuk dukej një plan dhe aq i komplikuar. Për më tepër ky lloj transporti ishte më i sigurti dhe më i shtrenjti në çmim. “Ty të jepet ai lloj shërbimi për të cilin pagan”, ishte motoja e botës moderne. Pak a shumë, sipas tij, do t’u duhej të ecnin në këmbë pa u diktuar nga rojat. Rruga kalonte rrëzë një kishë. Por që të shkonin aty, fillimisht do t’u duhej të ecnin buzë një përroi e një pylli ku nuk duhej të futeshin dhe as të ngatërroheshin. Thjesht duhet të ndiqnin rrjedhjen e përroit përgjatë bregut. Kur të shihnin kishën, kjo do të thoshte që ishin shumë afër kufirit gjerman. Me t’u hedhur në anën tjetër, duhej të merrnin një taksi të çfarëdoshme dhe t’i kërkonin t’i shpinte në pikën më të afërt ku paraqiteshin azilantët. Me sa dukej taksistëve u interesonte vetëm të bënin para dhe nuk kishin ndonjë interes të denonconin ata që hynin ilegalisht. Nëse paraqisje fakte të forta bindëse që jeta jote vazhdonte të ishte në rrezik në Shqipëri, kishte shanse të pajisjes me letër qëndrimi në Gjermani. Njeriun e mban shpresa, edhe sikur ajo të jetë e hollë sa një fije kashte. Bujari u kishte siguruar dhe ca vërtetime policie që ai i kishte të gatshme si formularë, ku thjesht plotësoje informacionet personale. Improvizonte gjithashtu histori të sajuara, të rreme, por bindëse që t’ua paraqisje pastaj atyre të emigracionit se si gjoja ishte kundërshtar dhe me opozitën e partisë në pushtet, të cilët nuk ishin gjë tjetër, por ish-komunistët që ndërruan pllakën. Nuk kishte rëndësi a ishte e vërtetë. Rëndësi kishte të

ishe i besueshëm dhe të fitoje azilin. Arrestimet nëpër demonstrata ishin prova e rrezikshmërisë në rast se të kthenin. Ligji ndërkombëtar për azilantët nënkuptonte se kushdo të cilit i rrezikohej jeta për arsye politike, nuk duhet të kthehej mbrapsht, vetëm në rast se provohej e kundërta. Kjo metodë e Bujarit nuk dukej dhe aq e rrezikshme, nëse krahasohej me metodat e tjera. Sa për paratë, meqenëse ai e njilte Marianën dhe kishte besim, e kishin lënë që ajo do t'ia paguante me rrogën e saj të parë. Ai e dinte që aq para mund të dukeshin një thesar për dikë aty, por ishte një shumë qesharake përkundrejt rrogave që merrnin njerëzit në Gjermani. Sapo të mbërrinin diku në pikën kufitare ku ai do t'i linte, do t'u duhej të bënin një copë rrugë në këmbë sipas udhëzimeve dhe, me të mbërritur në anën tjetër, do të ishin të lirë. Udhëtimi me makinë me Bujarin i kishte mbushur me shpresë. Si njeri që kishte shëtitur nëpër botë, gjë që ishte shumë e rrallë në ato kohë, u ngjallte besim sidomos me historitë që i tregonte me entuziazëm. Plani iu duk edhe më joshës dhe më i realizueshëm pasi panë në fillim Pragën dhe Bratislavën. Ishin mahnitur me arkitekturën. Katedrale, kisha, ndërtesa për të cilat kishin lexuar vetëm nëpër libra ose që i kishin admiruar nëpër filma; të tilla gjëra tani po i shihnin për herë të parë nga afër. Fatkeqësisht vendi i tyre nuk kishte ndërtesa të tilla ose arkitekturë si vendet e tjera, madje edhe disa të vjetra ishin rrënuar. Ky vendi i tyre vërtet ishte në zemër të Europës, por nuk

kishte asnjë ngjashmëri me të tjerët, përveç relievit natyror. I përngjante më shumë një insekti gjigant që i kishin bërë lloj-lloj eksperimentesh shkencore dhe kishte dalë më në fund diçka e bastarduar që kishte mbijetuar. A thua se dikush kishte pasur ndonjë inat me të e donte t'i zhdukte historinë që teknikisht nuk ishte dhe aq ndryshe nga ajo e vendeve të tjera fqinje. Kishin pasur ndër shekuj të njëjtët pushtues, por kishin një ndryshim, shqiptarët nuk kishin pushtuar kurrë askënd. Çfarë i bën disa popuj të pushtojnë e disa të tjerë të pushtohen? Karakteri? Pozita gjeografike? Instinkti i mbijetesës? Sigurimi i daljeve në det, të mirat materiale që një vend zotëron më shumë në krahasim me tjetrin? Mariana mendonte që ishte një kombinim i të gjitha këtyre gjërave bashkë. Shqiptarët kishin shpirt luftarak, por përkundrajt njëri-tjetrit. Ishin të këqijtë e vetes dhe ndoshta këto cilësi ishin shfrytëzuar nga pushtuesit për t'i përçarë e për t'i sunduar më lehtë.

\* \* \*

Mariana ishte e lodhur nga jeta në Shqipëri, ndoshta më shumë se të tjerët. Ajo kishte jetuar në institucionet shembull të abuzimit. Kur jeta është një zymti e madhe në një familje me prindër dhe të afërm që plotësojnë pak a shumë boshllëqet e panumërta, imagjino të jesh njeri pa njeri. Jetimore të ishin të mbushura me “fëmijë të këqij”, që nuk kishin njohur



kurrë përkëdheljen prindërore apo njerëzore. Për Marianën dhe, sigurisht, për të gjithë ata në pozitën e saj, e gjithë jeta e tyre ishte bazuar thjesht në instinktin për mbijetesë, ku mungonte një pikë referimi, pa dashamirësi, pa drejtim ose plan për jetën. E gjithë jeta e saj pat qenë një luftë e vazhdueshme për ekzistencë me një shpresë, e cila nuk i ndahej dhe e bënte të besonte se një ditë gjërat do të shkonin mirë. Luftë për të mos ia marrë ushqimet nga dora fëmijët më agresivë, sepse asnjëherë nuk jepej mjaftueshëm që të ngopej mirë. Luftë për të mos i marrë lodrat apo lapsat e paktë. Luftë për të mos i zënë banjën kur të bënte dush ose dhe thjesht të urinonte. Luftë me kujdestaret si gardiane burgu që ishin po aq pa shpirt sa shumica e fëmijëve atje. Me përjashtim të njëjës, që bënte dallim nga të tjerat dhe ishte pikërisht ajo që i kujtohej shpesh. E quanin Zana dhe kishte një vështrim të butë. Zana i drejtohej njerëzisht kur i kërkonte të bënte diçka, në kontrast me harbutërinë e të tjerave. Njëherë e kishte dëgjuar tek i thoshte një kujdestareje tjetër: “Mariana është ndryshe. Jo vetëm që është një fëmijë i këndshëm, por ka sjellje pothuajse të lindur aristokratike. E mendoj ndonjëherë pale kush do të kenë qenë prindërit e saj. Kurrë nuk kam parë ndonjë të afërm të vijë e ta kërkojë.” Kujdestarja tjetër kishte përmendur me zë të ulët, duke parë si e trembur majtas, djathtas mos i dëgjonte kush, se Mariana kishte pasur teze dhe daja, por askujt nuk ia mbante të vinte të tërhiqte fëmijën e

një çifti armik të pushkatuar nga Partia. Plus që kush e di nga i kishin degdisur dhe ata, sepse hakmarrja për armiqtë e pushtetit binte mbi gjithë të afërmit fatkeqësisht. Këto fjalë që dëgjoji nga rastësia jo vetëm e kishin tronditur, por e kishin munduar gjatë dhe për më keq nuk dinte ku mund të gjente ndonjë informacion për familjen e saj. Ajo nuk kishte asnjë lidhje me botën e jashtme dhe si të thuash pikërisht këta fëmijë të egër e këta kujdestarë pa shpirt ishin familja e saj e vetme. Por paskësh pasur dhe daja e teze që s'i kishte njohur kurrë dhe gjasat ishin që s'do t'i njihnte ndonjëherë. Pastaj e ngushëllonte mendimi që fundja ç'i duheshin të afërm të tillë që e kishin plasur aty që ta hiqnin qafe. Zana ishte i vetmi njeri i mirë që ajo kishte njohur dhe një ditë kishte marrë guximin ta pyeste se ku mund të gjente ndonjë informacion për prindërit e saj. Donte të dinte çfarë kishte ndodhur me ta. Zana nuk e kishte fshehur dot tronditjen që i erdhi nga kjo pyetje. Faqet e rrumbullakëta iu bënë të kuqe flakë nga gjaku që i vërshoi dhe iu përhap pulla-pulla nëpër gushë e deri në gjoks. Sytë iu errësuan sikur të kishte dëgjuar diçka të llahtarshme dhe dystoi mbrapa me nervozizëm kaçurrelat e zinj që i vareshin në fytyrë. Pastaj, e trembur, kishte parë rreth e qark për t'u siguruar që askush nuk kishte dëgjuar fjalët fatale që kishin dalë nga goja e Marianës dhe i kishte thënë: “Mariana, zemër, prindërit e tu nuk jetojnë më, ndaj ti je këtu. Të lutem, mos u përpiq më kot të kërkosh informacione, sepse do ta koklavitësh

për kot jetën. Ti je nxënëse shumë e mirë, ndoshta ndër më të mirat që ka shkolla, dhe ky duhet të jetë fokusimi yt, sa të mbushësh 18 vjeçe e të dalësh që këtej. Pastaj do të gjesh një punë dhe do të jesh e zonja e vetes e do ta përballosh vetë jetën. Lexo sa më shumë libra, merr sa më shumë njohuri, sepse ato nuk t'i merr dot askush dhe mund t'i mbash me vete përgjithmonë. Do të duhen në jetë.”.

Mariana nuk donte ta vinte në pozitë të vështirë kujdestare Zanën aq më tepër që ajo ishte e vetmja mike që kishte, sepse në vetvete ashtu e quante atë, një mikeshë të mirë. Nuk e përcaktonte dot saktësisht se kë, por i kujtonte një personazh librash nga ato që lexonte. Zana i sugjeronte libra të ndryshëm dhe përveç atyre që i detyronte Partia të lexonin, e kishte prezantuar me autorë botërorë, si Hygoi, Balzaku, Dymas. Libri “Konti i Monte Kristos” jo vetëm që e kishte mbajtur zgjuar gjithë natën, por e kishte lexuar tri herë. Po kështu edhe “Katedralen e Parisit”. Mariana kishte etje për dituri dhe pjesën më të madhe të kohës e shpenzonte pikërisht duke lexuar. I përpinte faqet që e çonin në një botë tjetër ku gjente prehje dhe ngushëllim. Ishte një arratisje e përkryer nga realiteti. Kishte dhe nga ato shoqe që u ngjallte kuriozitet përqendrimi i saj nëpër libra dhe e pyesnin hera-herës çfarë gjërash interesante thuheshin atje. Mariana gjallërohej dhe u tregonte me ëndje. Librat e bënin të mos ndihej vetëm dhe personifikohej me personazhet që kishin vuajtur shumë, ndonjëherë më

tepër se ajo vetë, e ia kishin dalë mbanë. Ndoshta kështu ishte jeta, e tillë me vuajtje dhe rreziqe që të duhej t'iu shmangeshe çdo ditë. Mariana nuk kishte parë jashtë këtyre mureve se si jetonin njerëzit e tjerë dhe as që e kishte idenë më të vogël. Ndoshta më mirë, por ndoshta edhe më keq. Ajo dinte vetëm që në jetimore të gjithë ishin fëmijë shumë të varfër dhe pa të afërm. Të vërtetën e botës përtej mureve të jetimores e mësoi vetëm kur la pas atë vend dhe kuptoi që jeta jashtë saj ishte njësoj e vështirë. Mësoi dhe sekretin e prindërve të saj që do ta ndiqte pas gjithë jetën si një hije. Prindërit e saj ishin shpallur armiq të pushtetit dhe kjo ishte gjëja më e tmerrshme që mund t'i ndodhte dikujt në diktaturë. Ata duhej të kishin qenë armiq të betuar të tij, sepse për këtë i kishin pushkatuar. Sa të rrezikshëm paskëshin qenë ata që të meritonin diçka të tillë? Dinte se të dy kishin qenë inxhinierë që punonin për ndërtimin e një dige të madhe, por më vonë u akuzuan për sabotim. Dyshimet kishin rënë menjëherë mbi ta, sepse ishin kundërshtarë të hapur ndaj regjimit komunist. Falë kësaj biografie katastrofike, Mariana nuk kishte të drejtë të ndiqte studimet universitare edhe pse kishte mbaruar shkollën e mesme me rezultate të shkëlqyera. Kishte kërkuar punë që të nesërmen, pasi ishte sistemuar në banesën që i kishin ofruar. Ishte një dhomë e vogël brenda një apartamenti, të cilin e ndante me dy familje të tjera, ku lagështia e mureve të depërtonte thellë në mushkëri dhe era e rëndë të

përplasej në fytyrë sa hyje brenda. Banja e vogël si birucë ishte e përbashkët. Nuk i bënte dot naze, sepse nuk kishte alternativa të tjera, pastaj ashtu jetonin të gjithë, dy-tre kurora në një apartament të vogël tipik të stilit komunist. Ajo veproi saktësisht siç e kishte udhëzuar Zana në mirëbesim: “Nëse të pyesin për prindërit, do të duhet t’i mohosh për të mbijetuar. Do t’u thuash me një ton të prerë, madje që ngjall besim: ‘Mua më rriti Partia dhe i përkas asaj.’”.

A duhej, vallë, ky udhëzim? “Nuk ngjallkam unë besim mjaftueshëm, por duhet dhe një improvizim teatral?” kishte menduar Mariana dhe mendjen ia kishte vagëlluar një hije dyshimi. Po sikur ky të ishte një provokim dhe Zana nuk ishte ajo që paraqitej si e mirë, por një agjente e sigurimit që punonte nën rrogë dhe priste që Mariana të binte në grackë? Mos ishte ky një truk që dhe ajo të shpallej armike pastaj? Duke u endur nëpër zyra pune kishte ndeshur në ftohtësinë e akullt të vartësve që, sapo mësonin kush ishte, nuk ngurronin t’ia bënin të qartë në sy se nuk kishin vende pune për të. Por kishte ndeshur, gjithashtu, dhe njerëz të mirë që i kishin folur me vështrim duke i hedhur një sy diplomës së saj me nota të shkëlqyera. Mariana pas shumë endjesh e gjeti më në fund një punë në Ndërmarrjen Komunale. Në fillim e morën si pastruese të thjeshtë, por meqenëse ishte e mirë në matematikë dhe u duhej një normiste, ia dhanë pozicionin me paralajmërim që të ishte e kujdesshme. E vetmja arsye që me atë biografi zuri

atë pozicion, ishin fjalët magjike: “Më ka rritur Partia dhe i përkas asaj.”. Zana paskësh pasur të drejtë, po ashtu dhe Mariana, që e kishte konsideruar atë që në fillim si të vetmen mike të mirë.

Sa më shumë rrihej me jetën dhe zbulonte hipokrizinë e saj, të lumtur në fasadë, aq më shumë i rritej urrejtja e brendshme për komunizmin. Ndonjëherë dyshonte se mos ishte gjenetike kjo gjë. Shpirti i saj i revoltës, të cilin ajo mezi e mbante të ndrydhur duke i ditur pasojat, ngrihej sa herë ndeshte në përulësinë dhe nënshtrimin e njerëzve të vuajtur. Degradim njerëzor, njeriu i ri i formuar sipas mësimeve të Partisë. Njerëzit e tjerë nuk dukej se e kishin të theksuar shpirtin e revoltës si ajo, se përndryshe do të kishin bërë diçka. Jo, ata i kishte pushtuar apatia dhe frika se po të thoshin diçka në kundërshtim me vijën e Partisë, përfundonin kush e di se ku. Preokupimi i tyre kryesor ishte të kryenin punët e përditshme, të siguronin atë pak ushqim duke ndenjur me orë të tëra nëpër radhët e gjata pa u ankuar dhe të qëndronin sa më larg radarit të qeverisë. Një jetë sikur ecje mbi vezë gjithë kujdes, sepse një fjalë e interpretuar gabim mund të kushtonte jetën jo vetëm ty, por edhe atyre që të rrethonin. Gjysmëshkullit që jetonin me këtë ritëm dhe kjo kohë ishte e mjaftueshme për të ndryshuar karakterin e shumicës, në mos të të gjithëve. Vëllai spiunonte vëllain, fqinji fqinjin dhe për çfarë, për t’u ndier më i sigurt vetë duke fituar simpatinë e autoriteteve. Ata

që drejtonin ishin njerëz të përzgjedhur, shumica injorantë e të pashpirt, të shkolluar në “Shkollën e Partisë”, e krijuar enkas për ta. Një institucion që përgatiste qen besnikë të pushtetit.

Me sa duket njerëzve u kishte shkuar thika në palcë, sepse ndryshimet erdhën, komunizmi u rrëzua. Vendi u përfshinë në fillim protestat, përleshjet me policinë dhe pastaj eksodi masiv. Të gjithë nxitonin të largoheshin drejt Perëndimit. Vendi ishte në kaos dhe gjithçka që po ndodhte e bënte Marianën të ndihej si një varkë e vogël e gjendur në mes të një oqeani të trazuar nga stuhitë që shkonte ku ta shpinin dallgët. E kishte vendosur të linte pas këtë humbëtirë që i kishte shkaktuar veç vuajtje e dhimbje asaj dhe prindërve që e sollën në jetë, por që nuk i takoi dot kurrë. Nuk vinte dot gjumë në sy kur mendonte aventurën që e priste dhe atë botë të panjohur ku do të hynte edhe pse historitë e këndshme që kishte dëgjuar e mbushnin me entuziazëm. Ndaj ajo e kishte besuar Bujarin si i vetmi njeri që mund t’ia bënte ëndrrën realitet. Por edhe Bujari e kishte besuar atë për paratë që Mariana do t’ia paguante më vonë. Aq i sigurt ishte që ajo do të rregullohej mirë atje, saqë i kishte kërkuar vetëm 200 marka në dorë dhe të tjerat kur të sistemohej në Gjermani. Mariana kishte kursyer çdo qindarkë dhe ishte ushqyer keq vetëm që t’i siguronte ato para. Përveç Marianës, në makinën e Bujarit ishte dhe një djalë 16-vjeçar. Vajza tjetër që supozohej të udhëtonte me ta, nuk kishte mundur të siguronte

paratë për transportin. Bujari kishte përshkruar edhe njëherë itinerarin që madje ia dha të skicuar në letër Marianës, siç ia kishte kërkuar ajo për t'u ndier më e sigurt. Ai do t'i linte diku buzë kufirit dhe rruga që duhej të përshkonin ecte përgjatë një lumi apo përroi të vogël, siç e quajti ai. Këto gjëra ishin përmendur aq shumë, saqë ajo i dinte tashmë përmendësh. Përgjatë lumit ishte dhe një pyll ku ata nuk duhet të futeshin, por të vazhdonin rrugën rrëzë një kishe si orientim që të nxirrte te disa shina treni dhe më pas te një tunel. Kur të futeshin atje duhet të siguroheshin që të mos kalonte treni, por, nëse kjo ndodhte, duhet të ngjiteshin fort pas murit e të mbaheshin pas hekurave derisa ai të kalonte. Pastaj, pasi të dilnin nga tuneli, me shumë rrezik ishte dhe ecja përgjatë pikës kufitare. Që të mos bije në sy të policëve, me trupin të përkulur duhet të ecje sa më shpejt, derisa të hyje në tokën gjermane. Sipas tij e gjithë kjo aventurë nuk duhej të zgjaste më shumë se një orë dhe me të mbërritur pastaj do të shihnin diku në një rrugë një hotel të vogël ku mund të trokisnin për të pushuar dhe t'i kërkonin të njoftohej policia, sepse ata pastaj do t'iu siguronin transportin për në azilin më të afërt. Dukej pothuajse absurde që policia të ishte kaq dashamirëse, por Bujari i kishte siguruar që në Perëndim gjërat funksiononin ndryshe.

- Kur të mbërrini në qendrën e azilantëve, kërkonti azil politik dhe e keni të fituarin statusin, meqenëse vini nga Shqipëria dhe *Voilà!*, i thoni pastaj jetës ku të kam parë e t'i bëni lapidar Bujarit, - u kishte thënë ai.



## KAPITULLI 2

Kushdo që nuk ka asgjë për të humbur, do të shkonte me guxim dhe entuziazëm drejt kësaj aventure. Të gjithë luftojnë për një jetë më të mirë dhe mbi të gjitha Mariana që nuk e pëlqente nënshtrimin. Rrugën e gjatë deri në kufirin Çeki-Gjermani nuk e kishte ndier, edhe pse nuk kishte vënë gjumë në sy. Mendimet i kishte aq të trazuara sa nuk mund ta linin të flinte. Pastaj kishin ndaluar në një zonë ku rruga kishte plot vajza që Marianës iu dukën të bukura. Të gjitha kishin veshur minifunde që nxirrnin në pah ca këmbë të gjata, veshur me geta si rrjetë peshku dhe qëndronin mbi sandale me platformë të lartë që i bënte të dukeshin edhe më të gjata. Mbanin veshur ndonjë

peliçe të shkurtër mbi trupin pothuajse të zhveshur dhe thithnin cigaret shpërfillëse me buzët e lyera me të kuq të ndezur e me varak që xixëllonte nga neonet e rrugës. Sytë iu dukeshin si dy zgavra të errëta nga makijazhi i rënduar.

- Këto janë prostituta çekoslllovakë, - u tha Bujari.

Gjithsesi edhe pse u shokua, sepse nuk kishte parë kurrë të tilla, Mariana mendoi që vajzat ishin të bukura përfundimisht. Pastaj, kur Bujari ndaloi disa kilometra më larg vendit të prostitutave, ishte qetësi dhe errësirë e thellë. Dolën jashtë, pastaj paguan Bujarin nën dritën e kabinës së makinës dhe ky i fundit u uroi fat duke u thënë të dilnin sa më shpejt jashtë dhe u largua me revansh duke i dhënë gaz makinës. Kishte arsye që ikte ashtu si një hajdut nate, sepse nuk u kishte treguar atyre gjithçka. Nuk u kishte treguar që distanca nuk ishte aq e shkurtër dhe se u duhej të ecnin brenda një tuneli të gjatë treni me një kalim. Pastaj duhej të bëje goxha rrugë më këmbë përgjatë kufirit rrëzë përroit të cekët ku lartësohej një pyll i dendur dhe i zi. Kishte ca kthesa që të shpinin drejt pyllit dhe nuk e dalloje mirë ku ndaheshin rrugët dhe cilin drejtim të merrje që të dilje në rrugën kryesore. Ishte mars, bënte ftohtë dhe nata fekste e mbështjellë me pak borë që qëmtonte lehtë. Mariana ishte veshur hollë si për Marsin e Shqipërisë, ku kishin çelur mimozat dhe kishin shpërthyer gjethet. Ishte errësirë e plotë që thyhej vetëm pasi të mësoheshin sytë nga rrezatimi i vagët që vinte hera-herës nga hëna që përpiquej të dilte

nëpërmjet reve. Mund të ishte dhe rrezatimi i dritave të largëta gjëkund dhe kjo mund të merrej si shenjë që po i afroreshin doganës. Mariana ishte aq konfuze dhe e trembur sa nga paniku që po i pushtonte gjithë qenien, ecte kuturu. Djali imcak që e shoqëronte nuk fliste. Zor që ai të ishte 16 vjeç. Duhej të ishte shumë më i vogël. U duhej të merrnin me mend rrugën që u kishte shpjeguar Bujari dhe sa për skicën e shkarravitur në një copë letër, as që u hynte në punë se ishte e pamundur të shihje në atë terr. Asaj iu kujtua që ai kishte përmendur se, kur të hynin në tunel, duhej të shmangin një tren të mesnatës se pastaj në mëngjes fillonin rutinën e rregullt trenat e shumtë. Tunelin ta përshkonin me vrap, me sa iu hanin këmbët. Nuk e kishte idenë sa ishte ora, sa kohë kishin ecur, deri ku kishin mbërritur, apo dhe sa rrugë mund të kishin ende për të bërë. “Ja dhe pak”, i thoshte jo vetëm vetes, por edhe Marios, djalit që kishte me vete. Ja, më në fund tuneli. U gëzuan të dy dhe nxituan hapat.

- Ka dritë në fund të tunelit, - tha Mariana si për të mposhtur frikën që po hynin në atë vend të errët ku nuk dukej asgjë. Verbëri e thellë, terr i zi.

- Nuk po shoh gjë, - tha Mario dhe nga zëri kuptohej që ishte po aq i trembur sa ajo.

Marianën e kapi paniku dhe iu duk sikur dëgjoji një zhurmë treni që po afrohej. Filluan të vraponin si të çmendur, derisa errësira filloi të bëhej më pak e dendur dhe vërtet kishte dritë në fund të tunelit, sepse pas pak u gjendën jashtë. Ndaluan pak, duke gulçuar

të përkulur me duart mbi gjunjë që të rregullonin frymëmarrjen. Nuk kishin më ftohtë, madje ishin djersitur dhe faqet u përcëllonin e duhet t'u ishin skuqur gjak. Kishte etje të tmerrshme.

Pasi dilje nga tuneli, shikoje dritat e stacionit doganor që ishte shumë afër. Mund të shihje policët që mbanin nga rripi qen të mëdhenj të racës “German Shepherd”. Kishte dy rrugë të ngushta që ndaheshin aty dhe njëra shkonte drejt doganës ose shumë afër asaj dhe tjetra drejt pyllit. Rruga e parë dukej e kollajshme dhe ajo e pyllit e errët dhe e frikshme, por sipas Bujarit ishte e shkurtër dhe më e sigurt, sepse nuk do t'i zbulonin dot rojet dhe pastaj t'i kthenin mbrapsht. I gjithë sekreti ishte të hidheshe në tokën gjermane dhe gjithçka pastaj shkonte për mirë vetë. Mariana e ndiente instinktivisht se duhej të merrte rrugën pa rreziqe, por fjalët e Bujarit i kumbonin në mendje dhe duhej të ndiqte udhëzimet e tij. Fundja ishte ai që e dinte rrugën dhe nuk kishte pse ta kundërshtonte idenë. Në kushte të tjera ajo do të ndiqte intuitën e saj dhe sinjalin që i jepte ajo. Zakonisht të parin sepse ai është i duhuri. i dyti është djalli që të flet në vesh. Kurrë nuk duhet të shkosh me hamendësinë e dytë. Morën rrugën drejt pyllit, por rruga mbaroi shpejt dhe një llucë e butë zuri të ngjitej nën këmbët e tyre. Detyrimisht dhe pa asnjë alternativë tjetër ata u futën në pyllin e dendur që nuk dihej a do t'i shpinte drejt destinacionit të shumëpritur. Pylli ishte i heshtur, misterioz, i errët dhe ashtu nëpër terr, Marianës iu bë

sikur shihte sy të verdhë që xixëllonin mes drurëve. E tmerroi ideja që aty kishte ujqër. Një detaj që Bujari kishte harruar ta përmendte, por që asaj nuk i kishte shpëtuar kur kishte parë tabela afër tunelit, të cilat njoftonin se në pyll kishte ujqër, ashtu si dhe drerë. Më mirë të mos i kishte parë, por për drej aty ku kishin qëndruar binte drita e doganës. Frikës që e mbërtheu jo vetëm i dha zë duke u lutur t'i shpëtonte Zoti, por e kapi një e qarë me dënesë. Një e qarë pendese që i kishte hyrë asaj rruge. Një e qarë inati që e kishte besuar Bujarin me shpresën e dobët që ai nuk do t'ia hidhte. Inati me veten që ishte treguar e dobët, inati me botën që ishte e pabesë ndaj saj, inati me fatin që kishte lindur në një vend që gjithçka lidhej me rropatje pa fund.

- Të lutem, mos bëj kështu, - i tha Mario të cilit iu ngjit paniku i saj më keq.

- Dua të kthehem, - klithi ajo, a thua se ishte faji i tij.

- Por do të na kapin e do na kthejnë në Shqipëri. Do të na ikë edhe mundimi, edhe lekët kot, - e kundërshtoi ai që dukej nga intonacioni sikur ishte dhe vetë në mëdyshje. Mbase i duhej vetëm miratimi i saj dhe ishte gati ta ndiqte pas.

- Por të paktën do të jemi gjallë. A nuk është më mirë të jemi gjallë? - ia ktheu prerë Mariana. Por jeta e saj nëse kthehej pas do të ishte një skëterrë e vërtetë, ashtu pa lekë, me borxh ndaj Bujarit, pa banesë dhe pa punë, të cilën e kishte humbur sigurisht.

- Ç'mendon të bëjmë? - e pyeti Mario që dukej se ishte po aq i gatshëm të kthehej, por thjesht priste vendimin e saj.

- Do të ecim përgjatë doganës me kujdes. Le të dalë ku të dalë. Në dorë të Zotit. Diçka më thotë që do t'ia dalim dhe kjo është rruga e duhur, - mërmëriti Mariana që për herë të parë në jetën e saj që pas rënies së komunizmit, i varte shpresat te Zoti, ai Zot që u ishte ndaluar edhe t'ia përmendnin emrin. U ndje mirë. Nuk u ndje më vetëm.

Mario nuk kundërshtoi, por e ndoqi pas i bindur. U kapën për dore dhe përpiqeshin që kur ecnin të kërrusur të mos dilnin mbi nivelin e shkurreve. Ishin aq afër saqë mund të dëgjonin zërat e oficerëve dhe madje të shihnin ecejaket e tyre me qentë përkrah. Nuk pipëtinin dhe pothuajse dëgjonin frymëmarrjen e njëri-tjetrit të fokusuar që të dilnin sa më shpejt të ishte e mundur nga ajo zonë.

Mariana nuk e kuptonte se çfarë ishte ajo forcë e brendshme që e shtynte përpara dhe i jepte kurajë. Dëgjoji një zhurmë, si një uturimë ritmike që nuk ndalonte. Ishte autostrada. Pastaj ajo u bë edhe më e qartë nga zhurma karakteristike e gomave të makinave në një kohë me shi. Kishte filluar një shi i imët bore, por që ata as nuk e ndienin më që i lagte. Dolën në një si park me stola, pastaj një trotuar dhe pak më tutje një shtëpi e madhe karakteristike gjermane me atë çatinë me kulm, me konture prej druri, me stuko, të lyera sikur të ishin të saponërtuara, me numrat metalikë

në anë të dritave të neonit që ndriçonin rrugicën që të shpinte te një portë e madhe si derë kështjelle me perçina metalike të errëta. Të gjitha këto krijonin një kontrast dhe njëkohësisht një harmoni arkitekturore shumë të këndshme për syrin. Ecnin kuturu pa ndonjë drejtim ose adresë dhe tashmë vendi ishte plotësisht i ndriçuar Mariana nuk kishte parë asnjëherë një ndriçim të tillë natën. “Ndriçim perëndimor!” tha me zë dhe qeshi. Qeshi edhe Mario pas saj. Dukej më i relaksuar dhe ai. Kishin hyrë në tokën gjermane. Ia kishin dalë më në fund.

- Shiko si jemi bërë, baltë e gjallë.

Të dy dukeshin si dy minj të lagur e të baltosur që endeshin të lodhur. Qeshën përsëri me zë. Ishte një e qeshur çliruese, një e qeshur triumfi. Ia kishin dalë dhe asgjë tjetër nuk kishte më rëndësi. Duhet të zbardhte së shpejti, por ata nuk dinin nga t’ia mbanin. Një gjë ishte e sigurt, që nuk kishte më kthim mbrapa. Përpara u doli një hotel i vogël dhe iu kujtuan fjalët e Bujarit: “Trokisni pa frikë se iu ndihmojnë njerëzit si të shkoni pastaj në ndonjë qendër azilantësh”. I ranë ziles dhe pas një zhurme dera u hap. E shtynë si të shushatur, sepse nuk kishte njeri pas saj, madje as sportelist. Menduan që kjo do të ishte diçka moderne e radhës. U hap drita e katit të sipërm dhe dikush po zbriste poshtë. Ky hotel dukej si një shtëpi nëpër ato kartolinat dimërore që vinin rrallëherë te ndonjë që kishte pasur familjarë të larguar në Perëndim që në kohën e para Luftës së Dytë Botërore. Te shkallët u

paraqit një burrë rreth 40 vjeç, biond, me trup të nxirë nga plazhi në mes të dimrit dhe me të mbathura. Ai dukej përgjumësh, u foli në gjermanisht diçka dhe e vetmja fjalë që Mariana kapi ishte “azil”. Ajri i ngrohtë i ambientit i dha një ndjenjë rehatie të munguar. Ai i ftoi të hynin brenda në sallonin e pritjes. Mariana hodhi njëherë sytë te këpucët e baltosuara dhe njëherë te gjermani si për t’u shfajësuar që po i ndotnin ambientin. Por ai që e kuptoi arsyen e ndrojtjes i tha diçka që nga gjestet nënkuptonte: “Nuk ka problem, hyni!”. Ai vazhdoi të fliste përsëri dhe Mariana i tha një nga shprehjet që kishte mësuar:

- Unë nuk kuptoj gjermanisht, jemi shqiptarë.

- Ah, komunizmi kaput! - i tha gjermani duke bërë një shenjë sikur priste kokën me dorën poshtë mjekrës në qafë, pasi kishte marrë vesh kombësinë e të sapoardhurve. Pastaj u bëri shenjë ta ndiqnin pas. Mariana përpiquej ta harronte faktin që ai ishte vetëm me të mbathura dhe nuk dinte ku t’i rrotullonte sytë. E ndoqën pas me një si përulje dashamirësie, sepse ishin aq të rraskapitur sa ishin gati të flinin mu aty në kanape në korridorin e hotelit. Hotelieri gjerman hapi derën e një dhome ku gjendeshin dy krevate të shtruara anës mureve në krahë të kundërt të njëri-tjetrit. U tregoi banjën, peshqirët dhe, si duket, pasi u rekomandoi një dush të mirë u shpjegoi diçka të tillë si: “Mëngjesi shërbehet poshtë nga ora 08:00-10:00” dhe u largua duke u uruar natën e mirë. Edhe pse ishin të rraskapitur ca nga rruga e ca nga stresi



për t'u futur me sukses në tokën gjermane, Mariana e vuri re komfortin e hotelit. Ngrohtësia që vinte nga kaloriferët ku rridhte ujë i ngrohtë, të shkrinte gjithë qenien. Temperatura e brendshme e hotelit të bënte të ndiheshë sikur të ishte korrik. Çarçafët ishin të bardhë me aromë të këndshme pastërtie, të hekurosur dhe të tendosur mbi dyshekun e butë. U fut të bënte një dush në banjën e mbuluar me pllaka të pastra e të lëmuara, jo si ajo me suva të rrjepur e apartamentit që kishte lënë pas. E pushtoi ndjesia e lumturisë që të japin gjërat e vogla, siç ishte uji i ngrohtë që i rridhte nëpër trup. Kurrë nuk ishte larë me ujë të bollshëm dhe pa frikën se nuk mjaftonte e duhej të laheshe shpejt e shpejt. E kapi një e qarë e pakuptueshme dhe i la lotët t'i merrte uji bashkë me hallet e panumërta të jetës së saj. I tha vetes që çdo gjë e ka një fillim dhe një fund dhe këtu ishte pak ndryshe. Ishte fundi i gjithçkaje të keqe dhe një fillim i ri. Shpirtin e ndjeu të lehtësuar dhe u mbush me një gëzim të papërshkrueshëm që nuk e kuptoi nga i vinte dhe për herë të parë fjeti një gjumë të thellë e të paqtë plotësisht. Të nesërmen hëngrën mëngjesin më të shijshëm që kishte ngrënë ndonjëherë. Një *semel* i butë, i rrumbullakët, i lyer me gjalpë, në mes ishte vendosur dhe një copë proshutë, nja 2 kuti të vogla me reçel brenda, ca lloje djathërash të prerë hollë dhe përveç kafes pa limit, kishte edhe qumësht e lëng portokalli. Të dy zgjodhën lëng portokalli, sepse nuk kishin provuar kurrë të tillë të ambalazhuar aq të bukur nëpër kartonë. Mariana e

konsideroi atë hotel të vogël si një vend luksoz ku kishte shkuar me pushime. Fundja, ëndërrimet janë pa para dhe ajo e la imagjinatën e saj të valëvitej e lirë. E përfytyroi veten të suksesshme diku në një të ardhme dhe nëpër udhëtime ekzotike ku do të çlodhej herë pas here ashtu si nëpër libra dhe filma. Mario lëpinte gishtat duke ngjyer dhe fundin e kutisë së reçelit. Dukej i kënaqur dhe për momentin ia kishte dhënë veten kënaqësisë së një mëngjesi të bollshëm që nuk e kishte pasur kurrë në jetë. I kishte pushtuar të dy një energji e mirë motivuese. Mariana e dinte që ajo do të kishte një jetë të mirë. Asgjë e mirë ose e keqe nuk zgjat përjetësisht. Pastaj po të mos kaloje ca peripecira në jetë si do t'i vlerësoje të mirat? Ku do ta dalloje ndryshimin? Yjet nuk ndriçojnë në kohë me diell, por kur bie nata...

Gjermani, që jo më kot Marianës iu duk zemërmirë, i dha rroba të ndërrohej dhe të vishej disi më praktike, jo sikur do të jepte lajmet e mbrëmjes në TV. I dha rroba më perëndimore në stil, një palë xhinse të zbardhura dhe me shtrat të lartë, siç ishte moda, dhe një xhup të shkurtër pak si të fryrë që i rrinin pak të mëdha. I pëlqeu ky stili i ri i veshjes, sidomos çizmet e shkurtra me perçina dhe ato një numër më i madh, por nuk kishte rëndësi. Pothuajse gjithë këpucët që kishte veshur në jetën e saj ishin të çara diku dhe i duhej t'i mbështillte këmbët me qese kur binte shi. Gjermani i shkroi në një copë letër fjalët: “Azil, taksi, Mynih, 200 marka për të dy”. Ai, sikur ta kishte porositur

dikush, e dinte saktësisht itinerarin e tyre. Apo mos ndoshta kjo ishte diçka e organizuar midis tij dhe Bujarit për të bërë ca para kontrabandë? Ç’rëndësi kishte. Mariana ishte gati të fillonte një kapitull të ri të jetës së saj. Nuk bëri asnjë lloj negociate, por numëroi paratë e përbashkëta dhe ia la mbi tavolinë gjermanit. Ai i numëroi përsëri dhe i hodhi një vështrim që nënkuptonte: “Si më beson që më jep parapagim?”. Për një moment kjo gjë ia përshkroi mendjen vërtet dhe u bind pastaj që dyshimet ishin një budallallëk i vërtetë dhe i vinin si pasojë e një jete ku t’i nuk beson dot askënd, sepse të gjithë të kanë zhgënjyer. Nëse gjermani do të kishte ndër mend të bënte diçka të tillë, do të mjaftonte një telefonatë policisë dhe biznesi i tij jashtë radarit deri atëherë, do të zbulohet direkt. Me sa dukej nuk ishte vetëm ajo që po përfitonte nga rënia e komunizmit, por dhe një grup i tërë kontrabandistësh e trafikantë klandestinësh. Nuk iu duk si diçka e tmerrshme, sepse njerëzit e saj kishin parë tmerre edhe më të mëdha andej nga vinte, madje i shilte këta si shpëtimtarë që po i ndryshonin jetën. Mariana kuptoi se si funksionojnë gjërat në jetë dhe se kudo që të jetosh do të luftosh për ekzistencë ose për një jetë më të mirë dhe e mira nuk ka fund asnjëherë. Kush është ngopur ndonjëherë me të mira materiale ose sukses dhe ka thënë: “Mjaft! Mbaron këtu!”? Askush, sepse gjithmonë dikush do të jetë më i pasur se ty ose më i suksesshëm se ty, gjë që do të bëjë të vraposh gjithë jetën të arrish të pamundurën.

E kapte shpesh veten tek humbte nëpër filozofime të tilla dhe mendoi se do ta lodhte më pak mendjen me gjëra të kota dhe të fokusohet tek e ardhmja e saj. Objektivi i saj kryesor ishte të hynte thellë në jetën e këtij vendi dhe të bëhej një ingranazh i tij. Kur u rehatua në “Mercedesin” e gjermanit, humbi e tëra në mendime duke shijuar udhëtimin disa orësh. Mario prekte me mollëzat e gishtërinjve sediljen e lëkurtë të “Mercedesit” dhe në fytyrë i ishte vizatuar një buzëqeshje e pafajshme. Mariana kur e vuri re, iu afrua dhe i tha ngadalë në vesh: “Më duket vetja si Vito Kapo!”. Marios i shpëtoi një notë e lartë e qeshure me zë gjë që e bëri jo vetëm Marianën të qeshte, por edhe gjermanin që si duket tha: “Dua dhe unë të qesh, me çfarë pëshpëritni aty!”. Si t’i shpjegoje atij që njerëzit e thjeshtë në Shqipëri nuk kishin parë kurrë nga afër një “Mercedes-Benz” dhe ato makina përdorëshin vetëm nga zyrtarët e lartë të Partisë...

## KAPITULLI 3

Aq e zhytur ishte në mendimet e saj dhe në vrojtimin e peizazhit gjerman nga përtej xhamave të makinës, saqë Mariana nuk e ndjeu fare rrugën disa orëshe. Kishin arritur pranë vendit që e quanin azil. Gjermani diç i thoshte dhe mezi e fshihte një lloj nervozizmi të brendshëm. Me sa kuptoi ajo, kishte të bënte me faktin që duhej t'i linte disi larg hyrjes kryesore dhe do t'u duhej të ecnin pak në këmbë, kjo ishte e gjitha. Nuk kundërshtuan sigurisht, por gjermani u zhduk në momentin e parë që ata dolën jashtë, sikur ta ndiqte njeri nga pas. Në momentin që u gjendën në mes të trotuarit me kalldrëm të gurtë dhe ndërtesave me arkitekturë magjepsëse, Marianën e kapi një lloj pasigurie.

- Po tani nga do t'ia mbajmë? - iu drejtua Marios, që dukej më i hutuar se ajo. Mariana e kishte në natyrë që në situata të vështira të merrte përsipër kontrollin e gjërave ndaj i dha drejtim situatës: - Çdo gjë do të jetë OK. Do të ecim pak dhe do na dalë para azili, ashtu si tha gjermani. Ne erdhëm nga kufiri, kjo është fushë me lule. Kjo është për ne si një shëtitje në park. Do të pyesim dikë fundja e do të na drejtojnë pastaj.

- Kush?! Këta?! Këta as që t'i hedhin sytë, nuk e sheh? - belbëzoi ai i shqetësuar këtë radhë.

Mariana e kishte vënë re një lloj indiference te njerëzit këtu dhe gjithashtu e dinte shumë mirë arsyen pse gjermani ishte dashamirës ndaj tyre, por nuk kishte frikë nga e panjohura. Më saktë, nuk kishte alternativë tjetër. Duhej parë veç përpara.

Ishte një ditë e ftohtë marsi, me një qiell gri ku nuk hynte asnjë grimcë dielli. Ishin veshur hollë në kontrast me temperaturën e atjeshme dhe rrobat e reja nuk ndryshonin gjë. Por gjermani nuk i kishte gënjyer. Nga distanca dukej ndërtesa tipike si institucion shtetëror, disi më moderne në stil dhe me shumë xhama e mermer gjithandej. Tek i afroreshin godinës, Mariana dallooi një grup njerëzish në radhë. Ishte në fakt një përzierje njerëzish të kombësive të ndryshme, somalezë, tunizianë, arabë, bangladeshas, europiano-lindorë. Të gjithë atje për të njëjtat arsye, por që do të merrnin pastaj rrugët e ndryshme të fatit të tyre. A thua mbanin statistika vendet pritëse të emigrantëve për të ndjekur progresin e tyre apo

ata thjesht i përpinte vorbulla e jetës duke bërë zakonisht punët më të rëndomta? Kur arritën më në fund pranë grumbullit të azilkërkuesve, radha tashmë ishte prishur dhe pak nga pak ata shtyheshin kush të hynte i pari. Ndoshta ky padurim i pakuptimtë u vinte nga frika se mos nuk i pranonin të gjithë. Ca ishin të qeshur, ca si të fjetur dhe disa të tjerë nervozë. Pas pak u shfaq një gjermane mesogrua që diç u bërtiste me zë të prerë, duke i treguar me gisht litarin dhe u tregonte të qëndronin brenda linjave e të respektonin radhën. Ata nuk i vuri re askush.

Azilantët zmbropseshin dhe bënë gjoja sikur e kishin mirëkuptuar, por, sapo gjermania ktheu krahët, filluan të shtyheshin përsëri. Nuk mund t'i fajësoje kur gjithë jeta e tyre kishte qenë një luftë e vazhdueshme për mbijetesë. Marianës iu bë sikur dëgjoji të flitej shqip. Iu tendosën shqisat dhe nuk kishte gabuar. Ishte një vajzë e re, pa mbushur të tridhjetat ndoshta, që pyeste me zë të lartë:

- A ka shqiptarë që duan përkthyes?

Mariana bërtiti në kor me Marion njëkohësisht:

- Po, po, ka këtu, - dhe ngritën dorën. Vajza shqiptare që, kishte një pamje plotësisht perëndimore, u afrua e buzëqeshur. Kishte mbathur çizme të zeza kastor deri te gjuri, kishte veshur një fund stofi të zi me ca si cirka, dy gisht mbi gju, ku i dukeshin një palë geta të zeza me vizë mbrapa, një golf të butë të zi dhe një xhaketë lëkure që i rrinte në mënyrë të përsosur. Të gjitha këto ishin në kontrast me flokët e verdha platin

të prera presje dhe që i shndrisnin e i valëviteshin nga shkrihtësia. Lëkurën e kishte të pastër, hirplotë, ku i spikaste një i kuq i lehtë rozë e hapur. Kishte dhe një lloj zhdërvjelltësie në lëvizje. Marianës iu duk aq e bukur dhe e përfytyroi veten që një ditë do të ishte si ajo, tërheqëse dhe duke folur një gjermanishte të rrjedhshme. Vajza shqiptare, e cila ishte me origjinë nga Kosova, por kishte lindur atje, vinte pothuajse çdo ditë për të ndihmuar si përkthyes azilantët shqiptarë. Madje në çantë kishte formularë emigracioni që pastaj ua plotësonte me të dhënat përkatëse. Patjetër që ata, ashtu si Mariana e bombardonin me pyetje për procesin dhe çfarë do të ndodhte më pas. A i trajtonin mirë azilantët? Sa kohë zgjaste të pajisesh me dokumente gjermane? A ishte e vështirë të gjeje punë? Po banesë? Mariana u habit kur mësoi se, sapo të regjistroheshin në sistem, shteti të garantonte banesë dhe ushqime pa limit, derisa të stabilizohesh në punë. Ti prisje aty ku të caktonin ata, derisa të dilje në gjyq në një datë të caktuar. Përpara gjykatësit avokati yt, përsëri i financuar nga shteti, paraqiste arsyet e tua pse t'i kërkoje azil atje. Ai shpjegonte situatën në vendin nga vije dhe sa i rrezikuar mund të ishe në rast kthimi. Përcaktonte pastaj statusin tënd. Asimeja, se kështu quhej vajza me origjinë nga Prishtina, kishte qenë si një engjëll mbrojtës i sjellë nga Zoti posaçërisht për ta. Përveç të tjerash ajo u dha dhe numrin e saj të telefonit, që t'i telefononin në rast nevojë. Mariana kishte dashur t'i ofronte diçka në shkëmbim për ndihmën,



sepse ishte mësuar që të paguante për çdo shërbim që mund t'i jepej. Asimeja, nga ana e saj, e siguroi se ajo e bënte këtë gjë vullnetarisht dhe pa pagesë, edhe sikur të mos kishte para, ajo nuk do t'i pranonte kurrë. Mariana e mori gjithçka si një ogur të mirë. “Do të më prijë e mbara, - mendoi me vete. - Çdo gjë po më shkon vaj si asnjëherë në jetë...”



## KAPITULLI 4

Mikrobusi me azilantë ndaloi përpara një shtëpie të madhe prej druri. Kishte një oborr të kuruar këndshëm, në të cilin kishte shpërthyer gjelbërimi. Ishte fund maji dhe ditë me diell. Mariana këto dy muaj kishte vënë re që ditët me diell ishin të numëruara në Gjermani. Kishte mësuar pak gjermanisht në një kurs intensiv që u ofronin azilantëve. Ajo ishte regjistruar atje e para. Ndihej e lumtur me jetën e re, me kushtet e jetesës, që për çudinë e saj ishin qendër kritikash të gazetarëve vendas se gjoja ai trajtim ishte i papërshtatshëm për emigrantët e kohëve të sotme.

Dikur ato godina ishin përdorur për ushtarët dhe banjat ishin të përbashkëta. Sipas tyre nuk ishte normale që një familje prej katër vetash të jetonte në një dhomë apo ushqimet që u jepeshin atyre, të

ishin në prag të afatit të skadencës. Marianës në fakt i dukej sikur kishte shkuar me pushime aty. Hajmi, siç e quanin atë vend, ishte një grumbull godinash njëkatëshe, të rregullta si kuti shkrepësesh, me rrugica të bukura ndarëse, bar të gjelbër dhe pemë të ndryshme. Vërtet që kishin vetëm nga një dhomë, banjë e dushe të përbashkëta, por nuk mund të krahasohej me kushtet me të cilat ajo ishte rritur. Lavatriçet e mëdha të larjes dhe të tharjes ishin të përbashkëta, por kishte aq shumë saqë gjithmonë gjeje të lira për përdorim. Çdo muaj u jepeshin kuponë për të marrë ushqime me bollëk dhe një herë në muaj edhe një çek për veshje edhe pse mund të zgjidhnin veshje pa fund që sillnin donatorët çdo ditë. Asnjë aty nuk punonte sepse ishte, si të thuash, qëndrim i përkohshëm, deri sa t'i shpërndanin nëpër qytete të ndryshme. Ajo u miqësua me disa boshnjakë. Djemtë i vardiseshin, ndërsa vajzat që ishin disi më të dala, e ndihmonin për t'iu dhënë përgjigje pyetjeve që ajo kishte. Një bangladeshase u tregoi se e mërkura ishte dita që gjermanët nxirrnin përpara shtëpisë orendi shtëpiake dhe mobilie që nuk u nevojiteshin më dhe mund t'i merrte kushdo, përpara se të vinte e t'i përmbliidhte makina e pastrimit. Mariana e kishte mbushur dhomën e saj me gjëra të tilla dhe, kur vije nga një vend i varfër si Shqipëria, gjëra të tilla ishin si një pasuri.

Gjuetia e rraqeve të përdorura, çdo të mërkurë, u kthye si një terapi për gratë e Hajmit. Kur gjenin

gjëra më të reja dhe më të bukura i hidhnin disa nga ato që kishin gjetur më parë dhe kjo ndjesia e bollëkut që ke aq shumë sa mund të hedhësh, ishte një lumturi më vete. Disa shqiptarë dërgonin ca nga këto veshje nëpër familjet e tyre dhe paguanin vetëm për postimin. Mariana e dinte se sa vlerë kishte atje të ishte i veshur e i mbathur, sepse edhe ajo gjë aq bazike nuk sigurohej dot. Në kohën që ajo ishte larguar nga Shqipëria dyqanet ishin bosh, pa ushqime të mjaftueshme, me mallra të pakta dhe pa veshje të përshtatshme sezonale. Gjëra të vogla në dukje, por që kur nuk i ke, marrin vlerë tjetër. Mariana nuk kishte askënd atje që ta bënte të lumtur, ndaj kur i rastisnin veshje për fëmijë nëpër thasët e gjetur, ajo ua dhuronte azilantëve të tjerë. Në një muaj kishte mbledhur aq shumë veshje dhe orendi, sa nuk i kishte pasur gjatë gjithë jetës. Një ditë gjeti një arush të madh, të murrmë, të butë, me sy si xham dhe që mbante në mes të duarve një zemër të kuqe me mbishkrimin “I love you!”. Pse ta kishin hedhur vallë? Ishte fare i ri dhe mund të kishte qenë dhuratë për dikë, por diçka kishte shkuar keq si duket dhe e kishin flakur pa asnjë thërrime sentimentalizmi. Ajo për vete nuk kishte pasur kurrë një të tillë, as në fëmijëri ndaj vendosi ta mbante si një dhuratë për veten.

Ndërkohë, koha kalonte. Të gjithë e dinin që qëndrimin në Hajm do t'i vinte fundi së shpejti dhe patjetër që do të shkonin në vendet e caktuara për ta. Ishte si një lloj lotarie, se nuk mund të përzgjidhje

qytetin që do të doje. Po as ndokush nuk kishte ndonjë preferencë të caktuar. Askush nuk e dinte as ditën se kur do ndodhte transferimi. Marianën dhe grupin e saj e njoftuan vetëm 24 orë përpara nisjes. I thanë që në mëngjes, në orën tetë, të prisnin në linjën ku ndalonin autobusët dhe një i tillë do të vinte t'i merrte për t'i transportuar në një vend tjetër që do të ishte disa orë larg. Ndenji vonë deri pas mesnate duke paketuar plaçkat dhe ndjeu keqardhje që shumë gjëra do t'i duhej t'i linte aty.

Gjëra që s'i kishte pasur ndonjëherë, si fustane mbrëmjesh që as vetë nuk e dinte se ku do t'i përdorte, por ishin në pronësinë e saj. Më shumë keq i vinte për orenditë, sepse i kishin dhënë atë ndjesinë e komoditetit, por sigurisht që nuk i merrte dot me vete. Por arushin e mori edhe pse ai ishte i madh pothuajse sa ajo. Në mëngjes, ashtu pak e lodhur nga pagjumësia se ishte përpëlitur e munduar derisa ta merrte gjumi, u gjend në pikën e pritjes. Kishte plot fytyra të panjohura gjë që tregonte se seleksionimi kishte qenë pa ndonjë përzgjedhje, siç i kishte kapur lapsi. Kur filluan të grumbulloheshin, vuri re që pothuajse të gjithë kishin sjellë me vete turli lloj asortimentesh: biçikleta, tenxhere, thasë me rroba. Biçikletat nuk i linin dot aty azilantët, sepse disa vërtet ishin të gjetura, por disa i kishin blerë nga azilantë që i kishin vjedhur në qytete të tjera dhe vinin i shisnin aty me çmime të lira. Marianës nuk i pëlqenin gjëra të tilla ndaj dhe nuk kishte blerë asnjë të tillë.

Autobusi erdhi në kohë dhe shoferi u hodhi një sy të vrenjtur dengjeve me rroba që prisnin të futeshin në bagazhin e autobusit të tij. Gjithë ato plaçka u përkisnin vetëm pesëmbëdhjetë njerëzve që do të udhëtonin me të. Pastaj murmuriti diçka nëpër dhëmbë dhe shkoi e shtypi një buton që hapi një derë në mes të autobusit diku poshtë dritareve. Mariana zuri vend anash një dritareje, pasi pa me kujdes se gjithë valixhet e saj ishin brenda në bagazhin e autobusit. Mario ishte transferuar në vend tjetër si minorene dhe ishte nën përkujdesjen e shtetit. Brenda pak minutash, rrëmuja mori fund dhe u nisën. Mariana ndiqte e humbur në mendime peizazhet që linin pas. Mes përfytyrimesh ëndërruese e linte veten të lirë të udhëtonte në skena ku e shihte veten të stabilizuar dhe me një jetë të re që nuk e kishte pasur kurrë më parë. Ishte lodhur së renduri duke kërkuar një jetë më të mirë. Kishte ardhur koha që kjo thjesht të ndodhte...

Kur arritën në destinacion, ajo ishte e përgjumur. Kishin udhëtuar disa orë dhe tani gjendeshin në një fshat të vogël malor. Ishte bukur, sikur kishe hyrë brenda një kartoline. Një sfond malesh të larta ngjyrë gri në blu, që e bënte pamjen edhe më piktoreske dhe një godinë sahati në mes ndërtesash me çati të kuqe. Kishte atje butikë të ndritshëm rrobash apo qelqurinash. Midis tyre spikasin lulishte me bar aq perfekt dhe të gjelbër, me lule nëpër ca vazo të gurta, skulptura kuptimplote dhe stola të këndshëm.

Autobusi ndalesën e parë e bëri përpara një restoranti. Shoferi i paralajmëroi të mos i ngacmonin bagazhet, sepse ishin aty vetëm për të ngrënë një drekë të përgatitur enkas për ta. U rreshtuan para tualetit në pritje për të kryer nevojat e tyre dhe, pasi lanë duart, zunë vende në tavolinën e pastër, të shtruar bukur, por thjesht, që i ngjante më shumë një gostie familjare. Në fillim u servirën një supë të ngrohtë dhe të shijshme. Pastaj dollma me lakër të bardhë me mish brenda me salcë domateje që kishin të njëjtën shije si të konservave që u jepnin në Hajm. Mariana kur i kishte provuar herën e parë, nuk kishte mundur t'i kapërcente dot dhe vërtet e kishte habitur fakti që dhe gjermanët hanin dollma lakre, por nuk kishin kurrsesi atë shijen e atyre që gatuante ajo. Të gjithë paskëshin qenë shumë të uritur, përderisa hanin ashtu të përqendruar me kokat ulur mbi pjata, pa folur, ku dëgjoheshin vetëm çukitjet e lugëve, rrufitje, mbllaçitje dhe ndonjë gogësimë që i shpëtonte dikujt. Në fund, u sollën nga një copë ëmbëlsirë të prerë në formë trekëndëshi *cheese cake* me disa kubikë pjepri, rrush dhe luleshtrydhe. Marianës vërtet iu duk sikur ishte duke ngrënë në një nga ato restorantet që shkonin njerëzit nëpër filma, sepse ëmbëlsira të tilla as që ekzistonin në vendin e saj të lindjes. Shprehja e kënaqësisë sikur i dilte nga e gjithë qenia, ishte më e zhdërvjellët në lëvizje, përdorte kur mundte fjalë gjermanisht që kishte mësuar asokohe dhe i gëzohej habitë që lexonte në fytyrat e njerëzve që sikur



thoshin: “Sa shpejt mësove gjermanisht ti!”. Kur mbaruan, një grua pak e mbushur, me syze në formë sy maceje, flokë të prerë shkurt dhe mollëza të kërcyera përpjetë e të kuqe me pak push si lëkura e pjeshkës, u tha të lanin duart përsëri dhe të zinin vendet në autobus. Ajo mbante një listë në dorë dhe i thërriste emrat një nga një, duke mos bërë asnjë shqiptim të saktë, gjë që e kalonte pastaj me të qeshur pas disa përpjekjesh të pasuksesshme. Edhe pse ishte e qeshur dhe i përshëndeste ngrohtësisht azilantët tek hynin në autobus, seç kishte diçka në vështrimin e saj, të cilën Mariana nuk e pëlqeu. Sa herë që i krijohej kjo ndjesi, përpiqej ta mposhte, sepse ishte e padurueshme dhe i krijonte një si pështjellim në stomak. Ndoshta s’kishte ndonjë gjë të keqe gjermania dhe mund të ishte thjesht reflektimi i syzeve me skelet të zi që u jepte syve të saj një shprehje të çuditshme.

Nuk u desh të vozisnin shumë këtë radhë dhe autobusi u ndal përpara një vile të bukur, e veshur pjesërisht nga jashtë me trarë druri të mëdhenj dekorativë. Gruaja me syze e urdhëroi shoferin të linte të gjitha valixhet diku në një vend dhe sytë e saj këtë radhë shprehnin tmerr: “Kaq shumë bagazh nga një grup kaq i vogël?!”. Dukej sikur grindej për diçka me shoferin, sepse ai përpiqej të shfajësohej duke ngritur supet. Kur azilantët vërshuan të rrëmbenin valixhet e tyre, ajo bërtiti e acaruar:

- Stop! Mos prekni asgjë!

Nxori një bllok të bardhë dhe u dha nga një fletë të gjithëve ku të shkruanin emrin dhe ta ngjisnin mbi valixhet përkatëse ose mbi dengjet që kishin sjellë. Azilantët bënë saktësisht atë që u kërkua dhe të qetësuar tashmë, ndoqën të bindur nga pas gjermanen. Ajo quhej Inga dhe i shpuri së pari në katin e parë në një kuzhinë jo shumë të madhe. U tregoi frigoriferin, dollapët e mbushur me pako të ndryshme biskotash ose me fruta të thata, patatina e gjithfarësoj gjërash. Me sa kuptoi Mariana, aty ishte vendi ku do të vinin të hanin vaktet e gatuara për ta në një orar të caktuar dhe çfarë kishte nëpër dollapë ishte për konsumim në rast se i merrte uria në periudhat ndërmjetëse. Dhoma tjetër që u tregoi ishte ajo e ndenjjes, me kolltukë e karrige, ku ata mund të rrinin e të shihnin televizor. U sugjeroi të përdornin bibliotekën e librave aty, por kjo ishte sa për të larë gojën, sepse askush për momentin nuk fliste mjaftueshëm gjermanisht e jo më të lexonte. Çdo gjë ishte e këndshme dhe pak aristokratike, në pamje të paktën. Më pas i erdhi radha sistemimit të tyre nëpër dhomat e fjetjes. Marianën dhe një vajzë bullgare, meqenëse ishin beqare dhe pa familje, i vendosi të ndanin të njëjtën dhomë. Çdo gjë ishte e këndshme dhe komode edhe aty. Marianës iu kujtua jetimorja ku kishte kaluar 18 vjet të jetës së saj dhe ku gjithçka bëhej me komandë dhe me detyrim, por që ajo nuk kishte asnjë alternativë tjetër përveç se t'i zbatonte. Ndoshta ishte e drejtë të mërzhitej dhe ndoshta e padrejtë të ankohej, por iu duk sikur po

e ndiqte e njëjta jetë si dikur, por këtë radhë me të vetmin përjashtim, me komoditet. Lotët iu mblodhën në grykë dhe nuk duroi dot pa bërë një pyetje me gjermanishten e saj jo të përsosur, por të kuptueshme.

- Sa kohë do të jetojmë këtu?

Inga u kthye me rrëmbim duke e parë me sytë e saj të turbulluar dhe duke u përpjekur të buzëqeshte. Në atë vështrim Mariana nuk e dalloi dot mirë nëse ishte habia e saj që ajo dinte gjermanisht, apo e habitur nga guximi që bënte një pyetje ku nënkuptohej qartë një lloj pakënaqësie.

- Nuk e di saktësisht, zonjushë, - u përpoq të tregohej e dashur Inga, ndërkohë që flegrat e hundës i dridheshin nga një lloj nervozizmi i brendshëm. - Ndoshta një vit, ndoshta më shumë.

Marianës i doli vetëm një “uau” dhe ndërkohë që përpiqej të formulonte pyetjen e dytë Inga kishte dalë duke tërhequr pas vetes derën e dhomës, por jo atë nga hyri. Dhoma që ajo do ndante me bullgaren ishte e lidhur me një derë tjetër me një si zyrë, ose të paktën ashtu iu duk, me aq sa arriti të shohë në shpejtësinë e hapjes dhe mbylljes së derës. Mariana mundi të shohë dy kolltukë mënjanë, një tavolinë me dy karrige përballë, ca libra dhe dokumente në një raft dhe e mori me mend që diku duhet të kishte dhe një makinetë kafeje tipike perëndimore. Në vendin e saj ekzistonte vetëm kafja turke dhe ekspresi mund të servirej vetëm nëpër kafenetë e pakta që ekzistonin. Ndërsa nëpër zyra nuk kishin salltanete të tilla. I erdhi